



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenin 22 në lidhje me nenit 114 paragrafi 3 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta zyrtare e Republikë së Maqedonisë, numër 12/2019) dhe nenin 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar me iniciativë të veten, në vazhdimin e parë të senacës së 46-të të mbajtur me datë 19.02.2021, morri

VENDIM

Në procedurën e inicuar në bazë të detyrës zyrtare, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vërtetoi se personi zyrtarë, ministër për në Qeverinë e RMV, në afatin e paraparë me ligj pas zgjedhjes në funksion nuk ka dorëzuar fletë anketuese dhe deklaratë për interesa deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, në kundërshtim me nenin 82 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Komisioni shtetëror në përputhje me kompetencat e veta ligjore të parapara në nenin 109 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, ka ngritur procedurë për kundërvajtje kundër personit, ministër në Qeverinë e RMV, pas të cilës në afatin e paraparë me ligj i njëjti e ka paguar gjobën.

Veprimi për lëndën me numër 09-3869/1 me datë 11.11.2020, **NDËRPRITET** dhe e njëjta të mbyllet dhe të arkivohet.

SQARIM

Lënda me numër 09-3869/1 me datë 11.11.2020 është e formuar me iniciativë të veten, në përputhje me nenin 17 paragrafi 1 pika 10 dhe 12 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, me të cilën Komisioni shtetëror e evidenton gjendjen vijuese të pronës dhe interesave dhe bënë kontrollimin e të dhënave nga deklaratat për gjendjen e pronës dhe interesave.

Komisioni shtetëror pas kontrollimit të bërë në evidencën e vet, ka konstatuar se personi, ministër në Qeverinë e RMV i zgjedhur në funksionin të cilin e kryen prej ditës 30.08.2020, me çka nuk e ka plotësuar obligimin ligjor të paraparë në nenin 82 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Neni 82

- (1) Personi i zgjedhur ose i emëruar, person përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik ose subjekt tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, noter, përmbarues, nënpunës administrativ nga kategoria A e caktuar me ligj ose person i punësuar në kabinetin e Kryetari të Republikë së Maqedonisë, Kryetari të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Nënkryetarët e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrat dhe sekretari gjeneral i qeverisë së Republikës së Maqedonisë përshkak se kryejnë detyra të punës të këshillatrit të veçantë, gjatë zgjedhjes, emërimit, gjegjësisht punësimit, kurse më së voni 30 ditë nga dita e zgjedhjes, emërimit gjegjësisht punësimit dorëzojnë deklaratë për gjendjesn e pronës dhe interesave.*

Pas kësaj gjendje faktike të konstatuar, Komisioni shtetëror deri tek personi dorëzoi urdhër-pagesë për kundërvajtje me lajmërim për shkeljen e bërë, se është i obliguar ta bënë pagesën e gjobës në vlerën e caktuar në urdhër-pagesën për kundërvajtje në afat prej tetë ditë nga dita e pranimit të urdhër-pagesës për kundërvajtje dhe të dorëzon dëshmi për pagesën e bërë deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit.

Në afatin e paraparë me ligj, personi zyrtar ka vepruar pas kërkesës së Komisionit shtetëror, mirëpo nuk ka dorëzuar dëshmi deri tek Komisioni shtetëror për pagesën e bërë. Komisioni shtetëror bëri kontrollim në evidencën e vet dhe vërtetoi se pagesë është bërë, personi zyrtarë dorëzoi listë anketuese dhe deklaratë për interesa.

Në bazë të të theksuarës më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROR PËR
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT**

Kryetarë: Biljana Ivanovska

Pas përfundimit të KSHPK

Përpunoi: K. Z., këshilltarë

Miratoi: K. N., anëtar i KSHPK